RAPORT VJETOR 2019

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tabela e lëndës

Fq.

Përshëndetja e Presidentit 3

1. Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2019 7

2. Organet e Urdhrit të Psikologut dhe aktiviteti i tyre funksional 36

2.1 Asambleja Kombëtare 37

2.2 Këshilli Kombëtar 39

2.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional 40

2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji 41

2.4 Administrata e Urdhrit të Psikologut 42

2.5 Komisione të tjera 43

2.5.1 Komisioni i Licencimit 43

2.5.2 Komisioni i Praktikës Profesionale 43

2.6 Koordinatorët Lokal 44

3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut 46

3.1 Psikologë të licencuar 46

4. Ndërtimi i regjistrit elektronik online 47

5. Rruga drejt provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut 48

5.1 Procedurat ligjore, konsultimet, takimet formale e informale, lobimet dhe korrespondenca institucionale shkresore dhe elektronike 49

6. Buxheti 53

6.1 Te ardhurat 53

6.2 Shpenzimet 54

7. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2019 56

8. Objektivat për vitin 2020 57

PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT

(Dr.Valbona Treska - Presidente)

Të nderuar kolegë e miq,

Është kënaqësi të ndaj me ju punën, sfidat, arritjet, problematikat dhe vështirësitë e hasura në rrugëtimin e Urdhrit të Psikologut gjatë vitit 2019.

Viti i tretë i punës së institucionit ka qenë mjaft dinamik dhe konstatohet lehtësisht se ka qenë një vit konsolidimi dhe fuqizimi për çdo psikolog, si dhe një vit i rritjes së standardeve të punës. Kemi patur këtë vit suksese të jashtëzakonshme, si anëtarësimi me të drejta të plota në Federatën Europiane të Psikologëve (European Federation of Psychologists' Associations), e në të njëjtën kohë edhe anëtarësimin me të drejta të plota në Organizatën e Psikologëve Organizacionalë dhe të Punës (European Association of Work and Organizational Psychology). Ndërkohë që, me një organizim perfekt, vullnetar të psikologëve nga e gjithë Shqipëria, mbajtëm mbi supe barrën e mbështetjes emocionale dhe suportit psikologjik për të gjithë të prekurit pas tërmetit të 26 nëntorit, ku mijra vetë mbetën të pastrehë dhe patëm 51 humbje jete.

Kemi vijuar gjatë këtij viti dhënien e dhjetra licencave për psikologët, kemi vijuar punën e Komisionit të Praktikave Profesionale, Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor dhe i kemi hapur rrugën aktiviteteve të para të Edukimit në Vazhdim të miratuara nga Komisioni i Edukimit në Vazhdim.

Ne jemi rritur këtë vit dhe, bashkë me ne, janë rritur aktivitet, pjesëmarrjet në konferenca, në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, në grupe pune, në takime me përfaqësues të pushtetit qëndror e lokal, në përfaqësime në rang institucional. Jemi rritur të gjithë bashkë, sepse jemi bashkuar për të fuqizuar dhe ngritur lart rolin e psikologut.

Kemi qenë pjesë e problematikave të grupeve të interesit, pjesë e

problematikave të anëtarësisë, kemi ofruar me qindra shërbime për psikologët dhe kemi qenë bashkë për të zgjidhur çështje, që prej vitesh kishin mbetur pezull.

Koordinatorët tanë lokalë kanë realizuar punë të admirueshme gjatë këtij viti në qarqet e tyre, kanë lehtësuar punën e anëtarësisë, kanë qenë me ta dhe për ta, sa herë ka lindur nevoja dhe kanë treguar se sa shumë punë mund të bëhet në mënyrë krejt vullnetare për profesionin, kur ke shumë dashuri dhe një qëllim të përbashkët.

Për herë të parë në historinë e profesionit në vend kemi hedhur hapa të sigurtë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kemi realizuar ëndrrën 25 vjecare për të qenë të barabartë mes të barabartëve. Anëtarësimi më 6 Korrik 2019 në Moskë, Rusi, në Federatën Europiane të Psikologëve (EFPA), ishte arritja më e madhe institucionale dhe profesionale që prej krijimit të Urdhrit.

Jemi vendi i 38-të anëtar i EFPA dhe kemi sot dëshirën, vullnetin dhe energjinë maksimale për të punuar pranë kolegëve tanë nga e gjithë Europa, për të qenë pjesë e grupeve të punës, për të ndarë mendimet dhe projektet tona, për t'u përfshirë në vendimmarrje e për t'i dhënë një tjetër dimension profesionit të psikologut në vend.

Anëtarësimi me të drejta të plota na hapë rrugën e përfaqësimit tonë me kandidatë psikologë profesionistë, të cilët janë të gatshëm të ofrojnë më të mirën në grupet e punës së EFPA-s ku do të aderojnë. Jemi pjesë e politikave në rang europian për profesionin dhe kjo na motivon maksimalisht për të rritur standardet tona profesionale.

Pas anëtarësimit tonë, në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar psikologëve shqiptarë, Presidenti i ri i EFPA Prof. Christoph Steinebach, ndër të tjera u shpreh: "*Jemi të lumtur që jeni pjesë e familjes tonë profesionale Europiane*". Në të vërtetë, nuk ka arritje më të madhe në një profesion, se sa të bashkohesh në një familje me kolegët. Jam e lumtur që këtë rrugëtim të parë ndërkombëtarë e nisëm bashkë. Për mua ishte një nga sfidat më të mëdha profesionale, por edhe personale, dhe jam e lumtur që e finalizuam që në vitin e tretë të Urdhrit të Psikologut.

Po aq i suksesshëm ka qenë për ne këtë vit edhe anëtarësimi në EAWOP (Organizatën e Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë), në 30 Maj 2019, në Torino të Italisë, ku u zhvillua Kongresi i 19-të i EAWOP me mijëra pjesëmarrës nga e gjithë bota.

Të gjitha këto suksese tonat, nuk do bëheshin të mundura pa punën, mbështetjen dhe dashurinë për profesionin të çdonjërit nga Ju. Kemi treguar gjatë këtij viti se jemi ndër komunitetet më të bashkuar të profesionistëve. E them me bindje të plotë, se pikërisht gjatë këtij viti i treguam njëri-tjetrit dhe të gjithë shqipatarëve, se mund të mbështeten

tek ne në raste katastrofash natyrore e krizash të mëdha kombëtare siç ishte tërmeti i 26 nëntorit.

Ka qenë një unitet i jashtëzakonshëm i treguar nga më shumë se 350 psikologë vullnetarë, që ju bashkuan ditë pas dite thirrjes tone, për ndihmë në zona të ndryshme të Shqipërisë, ku kishte të dëmtuar nga tërmeti.

Për ditë të tëra me rradhë, nën kaosin ku u gjendëm, bëmë një organizim perfekt, jo vetëm duke asistuar të madh e të vogël, që kishte nevojë për ne, por edhe duke gjeneruar të dhëna mbi situatën, mbi numrin e personave të dëmtuar të strehuar në hotele e çadra, të dhëna mbi numrin e fëmijëve, të moshuarve, e personave me aftësi të kufizuara. Në javën e parë, atëherë kur çdokush, përfshi këtu instancat shtetërore, bashkitë, përfaqësuesit e OJF-ve dhe shoqërisë civile, morën kohën për t'u organizuar, për të përballuar këtë fatkeqësi të madhe natyrore, që mori 51 jetë njerëzish, ne kemi qenë aty, në vijën e parë, të gatshëm për të ndihmuar me ç'të mundnim.

Si pasojë e koordinimit me grupet e terrenit, kemi njoftuar në kohë rekord institucionet për familje të ndryshme në zona të thella të Shqipërisë, të cilat kishin nevojë për batanije e ushqime pas shembjes së banesave. Shtabi i emergjencës ka bërë një punë të palodhur ditë e natë në koordinimin e 350 psikologëve krejtësisht vullnetarë, që i bëri së bashku humanizmi, profesionalizmi dhe gadishmëria për të qenë ndihmë 24 orë në 24.

Çdo natë, pas përmbylljes së raportimeve nga terreni, kemi përpiluar raportet ditore me të dhëna të mbledhura nga 52 pika në terren në të gjithë Shqipërinë dhe ua kemi vënë në dispozicion strukturave shtetërore dhe OJF-ve, me qëllim bashkërendimin e punës.

Sot që kthej kokën pas, ende më duket i pabesueshëm koordinimi përfekt që kemi patur mes nesh. Së bashku me bashkëpunëtorë të ngushtë, brenda 24 orëve, kemi udhëtuar nga Tirana në Durrës, më pas Thumanë, Lezhë, Shëngjin, Tiranë e Korcë. Kemi udhëtuar nga Tirana në Fier, më pas në Durrës, Bubq, Thumanë, Elbasan, sërisht Shëngjin e kështu me rradhë.

Çdo ditë jam përpjekur të jem aty me çdo psikologë që la shtëpinë e familjen për t'ju gjendur pranë me mijra të dëmtuarve të tërmetit. Jam përpjekur t'i motivoj, inkurajoj, mbështes e t'ju them në çdo moment "FALEMINDERIT", edhe pse sot, nuk jam ende e sigurtë a ua kam thënë mjaftueshëm, pasi janë treguar TË SHKËLQYER në çfarë kanë bërë!

Në fund të vitit që lamë pas, ishte e pamundur të jepnim çmimin "Psikologu i vitit 2019" për vetëm një psikolog, që kishte dhënë kontribut profesional gjatë vitit për kumunitetin. Çmimi "Psikologu i Vitit 2019" i'u dha në fund të dhjetorit, plot 81 psikologëve në të gjithë Shqipërinë, që ishin aty për të

ndihmuar që në orët e para të datës 26 nëntor. Ishte minimuni që ne të gjithë mund të bënim për ta!

Të nderuar kolegë e miq!

Shumë punë janë bërë gjatë këtij, viti të cilat mund t'i shqyrtoni në vijim të këtij raporti vjetor, por personalisht zgjodha që në këto fletë të para, të ndaj me ju në veçanti dy nga momentet me domethënien më të madhe profesionale që përjetuam gjatë 2019: Anëtarësimin në EFPA dhe mbështetjen që ofruam për mijra njerëz në tërmetin e 26 nëntorit.

Jam e bindur se këto dy situata të jashtëzakonshme, njëra e mbuluar nga emocione pozitive dhe tjetra nga frikë, pasiguri, ankth e tension, kanë shënjuar punën e të gjithë vitit 2019 për psikologët.

Në vitin e tretë të tij, Urdhri i Psikologut tregoi se sa më të mëdha arritjet e sfidat, aq më të sigurtë jemi në hapat që hedhim së bashku.

Përzemërsisht,

Valbona Treska

Presidente

Tiranë, Shqipëri
Janar 2020

1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2019

Kemi bërë së bashku një rrugë të mrekullueshme profesionale gjatë këtij viti. Çdo muaj ka patur aktivitete të rëndësishme për komunitetin e psikologëve.

Janar

➢ Puna e Urdhrit nisi gjatë këtij viti me zgjerimin e rrjetit të Koordinatorëve Lokalë. ***Grupit të koordinatorëve të qarqeve Shkodër, Lezhë dhe Korçë, i'u shtua edhe Koordinatori Lokal i Qarkut Fier.***

Në datë 29 janar, përpara komunitetit të psikologëve të Fierit, prezantuam Znj.Silvana Kostrica, e cila, sikundër kolegët e saj në qarqet e tjera në vend, mori përsipër vullnetarisht realizimin e kësaj detyre.

Znj.Kostrica, një profesioniste me shumë vite përvojë dhe e vlerësuar nga kolegët e saj, ka ndihmuar gjatë këtij viti jo vetëm duke i qenë më pranë anëtarësisë, por edhe duke promovuar e forcuar rolin e psikologut në këtë qark. Puna e saj dhe e kolegëve të Fierit ka qenë gjithashtu edhe mbështetje për kolegët e tjerë, veçanërisht në termetin e 26 nëntorit, ku i'u bashkuan për ndihmë grupit të psikologëve nga e gjithë Shqipëria.

Shkurt

➢ ***Në një bashkëpunim shumë frytdhënës me kompaninë e mirënjohur ndërkombëtare "Giunti Psychometrics", realizuam në muajin shkurt trajnimin informativ "Roli i Psikologut të punës, mjetet dhe fushat e ndërhyrjes".*** Për shumë vite kemi vënë theksin në mungesën e testeve të standardizuara dhe në mungesën e mjeteve efikase të vlerësimit psikologjik të individit.

Në 12 shkurt të këtij viti, në një sallë me më shumë se 100 psikologë pjesëmarrës, për herë të parë prezentuam një sërë testesh të standardizuara, të cilat mund të përdoren specifikisht nga psikologu organizacional, por jo vetëm. Qëllimi i trajnimit ishte, jo vetëm prezantimi i këtij katalogu testesh, të cilat plotësohen online dhe rezultatet gjenerohen për disa minuta nga sistemi, por edhe fuqizimi i rolit të psikologut të punës dhe organizacional në Shqipëri. Kompania "*Giunti Psychometrics*", në bazë të një marrëveshje dypalëshe të nënshkruar, i dhuroi çdo anëtari të Urdhrit të Psikologut 100 kredite bonus për të shkarkuar dhe plotësuar pa pagesë minimalisht 5 teste të standardizuara. Teste të tilla, si ai i personalitetit *"Big Five Questionnaire-2",* testi i lidershipit *ALQ*, testit mbi motivimin *TOM* dhe *WOMI*, e të tjera teste bashkëkohore, janë tashmë në gjuhën shqipe në duart e psikologëve dhe do t'i ndihmojnë ata në punën e përditshme në rritjen e standardeve profesionale.

➢ Po në shkurt 2019, ***finalizuam me sukses bashkëpunimin me UNICEF në botimin e broshurave të para informuese për rolin e psikologut në procese të drejtësisë ku përfshihet dhe i mituri.***

Prokurorët dhe gjyqtarët e seksionit civil, familjar e penal, në të gjithë vendin, tashmë kanë në duar materiale që u vijnë në ndihmë, me informacione të detajuara, lidhur me rolin dhe mënyrën e përzgjedhjes së psikologëve në të gjitha proceset në fushën e drejtësisë.

Botimi i këtyre broshurave vjen pas përfundimit me sukses të trajnimeve të para specializuese të realizuara nga Urdhri, për të çertifikuar psikologë, të cilët mund të përfshihen në të gjitha fazat e drejtësisë ku përfshihen të miturit.

➢ **Asambleja e III Kombëtare e Urdhrit të Psikologu zhvilloi punimet më 22 shkurt 2019 në qytetin e Korçës.**

Nisma për të zhvilluar çdo vit një asamble lëvizëse, e cila do të shkojë ndër vite në çdo qytet ku ka psikologë, këtë vit mblodhi në Korçë kolegë nga e gjithë Shqipëria. Realizimi i këtij aktiviteti kombëtar profesional, i pasqyruar edhe në mediat lokale, jo vetëm që promovon rolin e psikologut në qytet, por edhe e fuqizon atë.

Në një kuvend profesionistësh morëm vendime të rëndësishme dhe diskutuam mbi problematika të institucionit dhe profesionit.

Në ngjarjen më të madhe profesionale të vitit, psikologë nga e gjithë Shqipëria patën gjithashtu mundësinë të qëndrojnë gjatë me njëri-tjetrin, të socializohen dhe të kuptojnë të përbashkëtat e të veçantat e punës në qytete të ndryshme të vendit.

Gjatë punimeve të asamblesë u bë gjithashtu një paraqitje e punës vjetore të vitit 2018 të Urdhrit dhe organeve të tij.

Mars

➢ Aktivitet e Urdhrit vijuan në 12 mars me ***një takim të organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Shkodër, në qytetin e Kukësit.*** Në këtë takim ku morën pjesë përfaqësuesi i U.P, Z.Igli Cutra dhe Koordinatori i Qarkut Shkodër, Z.Altin Nika, u diskutua rreth problematikave të ndryshme, që psikologët e qarkut Kukës kishin hasur në punën e tyre të përditshme, me tematika që u fokusuan më së shumti tek psikologët shkollorë, si dhe psikologët në fushën e drejtësisë.

Gjatë këtij viti, zyra qëndrore e UP, në bashkëpunim me koordinatorët, ka synuar të jetë sa më pranë anëtarësisë me takime e diksutime të shpeshta me ta.

➢ *Gjatë muajit mars* ***doli botimi i parë i Urdhrit të Psikologut: Kodi i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor dhe Rregullorja e Gjykimit Profesional.*** Kodi i Etikës, i cili hyri për herë të parë në fuqi më 30 qershor 2017 nga Asambleja e Parë Kombëtare, mori

formën e një botimi të plotë, në mënyrë për të qenë më i lehtë në përdorim nga çdo profesionist psikolog.

Kodi i Etikës është bibla e profesionit, ndaj Urdhri i Psikologut e përzgjodhi për të nisur një rrugë të re të institucionit, atë të botimeve, të manualeve, protokolleve e guidave, të cilat në vazhdim, do t'u vijnë në ndihmë profesionistëve në specialitetet e tyre përkatëse të psikologjisë.

Prill

➢ Kemi vijuar intensivisht takimet me anëtarësinë në qytete të ndryshme të Shqipërisë. ***Takimi i rradhës u realizua më 19.04.2019 me komunitetin e psikologëve në Lushnje***. Takimi u realizua në bashkëpunim me Koordinatoren e Qarkut Fier Znj.Silvana Duka Kostrica. Takimi pati qëllim diskutimin e problematikave të psikologëve të këtij qyteti, procedurat mbi licencimin, vonesat në realizimin e provimit të parë të shtetit, etj.

Maj

Një prej qëllimeve të U.P., që prej krijimit të tij, ka qenë fuqizimi i rolit të psikologut, duke qenë gjithmonë e më pranë anëtarësisë tonë në problematikat e punës së përditshme, që ata hasin. Pas shtrirjes së rrjetit të koordinatorëve në Fier, një tjetër qark ju shtua punës së tyre vullnetare. ***Në datë 21 maj prezantuam Z.Elton Kuqja si Koordinator të Qarkut Durrës***.

Z.Kuqja do të mbulojë me shërbim në rolin e koordinatorit edhe qytetin e Kavajës dhe të Rrogozhinës.

Gjatë prezantimi të tij, kolegët e Durrësit vlerësuan vullnetin dhe dëshirën e Eltonit për të kontribuar profesionalisht për qytetin. Pas nënshkrimit të kontratës mes Urdhrit dhe koordinatorit lokal, u vijua me diskutime për problematikat që hasin psikologët e Durrësit, Kavajës dhe Rrogozhinës, si dhe u vlerësuan mundësitë e zgjidhjes së tyre.

Tashmë kemi një shtrirje të gjerë në të gjithë Shqipërinë me koodinatorë lokalë dhe hartës synojmë që t'i shtojmë së shpejti edhe të tjerë kolegë në qytete të tjera të vendit.

➢ Maji ka vazhduar të jetë muaj suksesi dhe aktivitetesh. Në punën e vazhdueshme që kemi bërë për të konsoliduar marrëdhëniet tona ndërkombëtare, që në muajin e parë të krijimit të U.P., **kemi arritur të finalizojmë me sukses më 31 Maj 2019, anëtarësimin tonë me të drejta të plota në Europen Association of Work and Organizational Psychology (EAWOP).**

Ky ishte i pari anëtarësim i komunitetit të psikologëve të Shqipërisë, në më shumë se 25 vite psikologji në vend, në një organizatë Europiane të këtij niveli.

Urdhri i Psikologut u përfaqësua nga Presidentja, anëtarja e Këshillit Kombëtar Znj.Valbona Habili, dhe anëtarja e Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Znj.Migena Buka. Të dy koleget gjatë këtyre viteve janë

angazhuar në mësimdhënie në psikologji organizacionale dhe të punës, pasi aplikimi i kësaj fushe ka qenë i vështirë në Shqipëri.

Me anëtarësimin në EAWOP ne synojmë aktualisht fuqizimin e rolit të psikologut të punës dhe organizacional, pasi, deri më tani, me qindra studentë janë dilomuar në këtë disiplinë dhe ndërkohë janë të angazhuar në fusha të tjera të psikologjisë, ose edhe jashtë profesionit, për shkak të mungesës së pozicionimit të psikologut të punës në sektorin publik dhe privat.

Qershor

➢ Në qershor kemi vijuar aktivitetet me disa takime me studentë të Universiteteve të ndryshme në vend, të cilët ishin në përfundim të studimeve master. **Një prej këtyre takimeve u zhvillua në zyrat e Urdhrit me një grup studentësh të masterit në psikologji, pranë Universitetit të Durrësit "Aleksandër Moisiu".**

Shumë kënaqësi të ndanim së bashku punën e U.P., objektivat, problematikat, si dhe hapat që duhet të ndërmarrte secili prej tyre pas përfundimit të studimeve, deri në marrjen e licences profesionale.

Me ta, diskutuam edhe për mënyrën se si mund të zgjidhim sa më parë problematikën e krijuar me studentët e ciklit psikologji-sociologji të këtij Universiteti, për anëtarësimin pranë Urdhrit. Prej dy vitesh studentët e këtij cikli nuk mund të regjistroheshin si anëtarë të Urdhrit, për shkak se program i tyre i studimit përmbante në emërtim dy fusha të ndryshme, siç janë psikologjia dhe sociologjia. Në korrespondencë të vazhdueshme, si dhe me vullnet e dëshirë nga të dy palët, në korrik të këtij viti, me vendim të Senatit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", ky cikël studimi në bazë të numrit të krediteve, u kategorizua dhe riemërtua si "master në psikologji". Kjo i ka hapur rrugën e anëtarësimit në Urdhër dhe licencimit, dhjetra studentëve, të cilit ishin në pritje, që prej janarit 2017.

➢ ***Takimet me studentët në përfundim të masterit dhe në pritje të regjistrimit në Urdhër, kanë vijuar me studentët e Universitetit Europian të Tiranës, departamenti i psikologjisë.***

Kemi konstatuar se, për shkak se Urdhrit është institucion i ri, ende ka paqartësi lidhur me procedurat e regjistrimit, legjislacionin e posaçëm, dokumentacionin që duhet të paraqitet, etj.

Në këto kushte, takimet të cilat më së shumti kanalizohen në pyetje-përgjigje të studentëve, i ndihmojnë ata të kuptojnë rreth procedurave që duhet të ndjekin.

➢ Psikologët kosovarë prej disa kohësh po përpiqen të krijojnë dhomën e tyre të psikologëve.

Për t'i përkrahur e për të ndarë eksperiencat tona me ta, një grup i Urdhrit me në përbërje Presidenten, stafin e U.P. dhe koordinatorët lokalë Besmir Frroku dhe Elton Kuqja, udhëtuan në Kosovë për të realizuar një takim dy palësh.

Në datë 14 qershor u realizua një takim pune në Prishtinë me Zv.Ministrin e Çështjeve Sociale dhe Zv.Ministrin e Shëndetësisë, si dhe takime me një pjesë të trupës së komunitetit të psikologëve të Kosovës.

Udhri i Psikologut ka krijuar tashmë një përvojë të vyer dy vjeçare dhe duke vlerësuar problematikat e përbashkëta me psikologët e Kosovës, kemi vënë në dispozicion të tyre të gjithë eksperincën tonë, si dhe legjislacionin e rregulloret e komisioneve të ndryshme të U.P., me qëllim që edhe kolegët tanë Kosovarë, të mund të ecin me hapa më të shpejtë në ndërtimin e dhomës së psikologëve, gjë që do të fuqizojë dukshëm rolin e psikologut, si dhe do të rrisë shkëmbimet profesionale mes vendeve tona.

➢ Një prej problematikave kryesore në zbatimin e ligjit 40/2016 të Urdhrit të Psikologut, mbetet mosrealizimi i

provimit të parë të shtetit. Në vijim të këtij raporti do të ketë një rubrikë të veçantë për të gjitha procedurat ligjore e takimet që janë zhvilluar gjatë vitit 2019 për realizimin e provimit të parë të shtetit.

Në vijim të këtyre veprimtarive, në periudhën maj - qershor kemi realizuar disa takime, ndër të cilat edhe ***takimi i datës 18 qershor me përfaqësues të universiteteve publike dhe jopublike të departamenteve të psikologjisë, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit.***

Tryeza e rrumbullakët u organizua me qëllim diskutimet mbi projekt - V.K.M që presim të miratohet mbi profilet e psikologjisë, për realizimin e provimit të shtetit.

Korrik

- **Anëtarësimi në EFPA 06.07.2019**

Në korrik, një përfaqësi e Urdhrit të Psikologut kryesuar nga Presidentja Valbona Treska së bashku me stafin, udhëtuan në Moskë, të ftuar në Asamblenë e Përgjithshme të EFPA.

Është një punë që ka nisur që në mars të 2017, menjëherë pas ngritjes së U.P. Korrespondenca me ndërkombëtarët, takimet dhe lobimet me ta për të qenë pjesë e EFPA, u finalizuan me kërkesën zyrtare në janar 2018 për anëtarësim.

Në datë 06.07.2019, e mbledhur ne Moskë, Asambleja e Përgjithshme e EFPA (European Federation of Psychologists' Associations), votoi me unanimitet anëtarësimin e Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë, si anëtari i 38-të me të drejta të plota në këtë organizatë.

Kjo ishe arritja më e madhe e këtij viti dhe ndoshta edhe e shumë viteve që do të pasojnë.

Anëtarësimi në EFPA ishte ngjarja më e madhe profesionale e Urdhrit të Psikologut. Edhe sot që punojmë këtë raport vjetor duket e pabesueshme çfarë mundëm të arrinim në vetëm 2 vite punë. Pas anëtarësimit Presidentia Valbona Treska bëri një prononcim të hapur për të gjithë kolegët e miqtë e U.P. Është një prononcim me shumë emocion, ndaj vendosëm ta lëmë të plotë.

Prononcimi publik i Presidentes Valbona Treska pas anëtarësimit në EFPA:

"07.07.2019
WE DID IT"

Urdhri i Psikologut pjesë e psikologëve të Europës!❤❤❤❤

Kam kënaqësinë e madhe dhe privilegjin të ndaj me Ju arritjen më të madhe të Urdhrit të Psikologut, si dhe të të gjithë komunitetit të psikologëve në më shumë se 20 vite psikologji në Shqipëri.
Në datë 06.07.2019, në Moskë, Asambleja e Përgjithshme e EFPA (European Federation of Psychologists' Associations), votoi me unanimitet anëtarësimin e Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë si anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë.
Është e vështirë të shpjegohen në letër emocionet për realizimin e kësaj ëndrre të hershme. Në fund të vitit 2016, ndërsa përgatiteshim për zgjedhjet e para dhe asamblenë themeluese të U.P., kemi diskutuar mbi EFPA-n dhe, ndërkohë që lundroja në faqen e saj të internetit, me shumë pesimizëm jam shprehur: "Ne këtu duam 20 vjet të anëtarësohemi!". Por, kur punët bëhen me shumë pasion, kur punon me përgjegjësi dhe ke një vizion të qartë, kur nuk ndalon të merresh me këdo që të zë rrugën, 20 vite mund të bëhen edhe 2 vjet.

Është një punë që ka nisur që në mars të 2017, menjëherë pas ngritjes së U.P. Korrespondenca me ndërkombëtarët, takimet dhe lobimet me ta për të qenë pjesë e EFPA, u finalizuan me kërkesën tonë zyrtare në janar 2018 për anëtarësim. Edhe pse gjatë takimit me Presidentin Baptista në Lisbonë, Portugali, në shkurt 2018, na u premtua mbështetje, sërish i gjithë procesi i anëtarësimit dukej një ëndërr.

Në 18 maj 2019, në mëngjes, ndërkohë që shkoja në zyrë, kam lexuar në makinë me një frymë e-mailin e dërguar nga EFPA Head Office, ku thuhej se Komiteti Ekzekutiv kishte marrë vendim të dërgonte aplikimin tonë për votim në Asamblenë e Përgjithshme, që do të mblidhej në Moskë. Mezi kam pritur të vrapoj në zyrë e t'i tregojë lajmin stafit. Kishim 2 vjet që prisnim për këtë përgjigje. Kemi lexuar dhe rilexuar disa herë në zyrë e-mailin dhe madje e kemi zmadhuar shkrimin për të parë më qartë e për t'u siguruar se po kuptonim atë që po lexonim. Ishte aq e pabesueshme!

Çdokujt nuk i duhen më shumë se disa sekonda për të lexuar këtë ngjarje të U.P., por, sinqerisht, pas saj janë orë e muaj punë, janë lodhje, mundim, dëshirë për të shkuar përpara, por ndonjëherë edhe për të hequr dorë, kur kupton se sa mendjengushtësi, djallëzi e keqdashje ka nga disa që nuk u pëlqen rruga jonë drejt suksesit.

Por besomëni, të gjitha shuhen kur je përpara Asamblesë së EFPA, me psikologët më të mirë të të gjithë Europës, për të mbajtur fjalën mbi kërkesën për anëtarësim. Madje kupton edhe më qartë se çdo të thotë të ecësh përpara. Është emocion që nuk përshkruhet kur Komiteti Ekzekutiv shprehet se: "Aplikimi i Shqipërisë ishte perfekt!" Dhe në fund të votimit e duartrokitjeve, emocionet e lotët janë të papërmbajtëshme.

Kjo është arritja më e madhe e psikologëve të Shqipërisë!!!

Krenare dhe mirënjohje për punën e bërë nga stafi i vogël i U.P. në këto 2 vjet.
Mirënjohje për Edin, Besin, Elonën, Altinin, Silvanën, Andin dhe Eltonin, që kanë qenë gjithmonë pranë në të gjitha problematikat e Urdhrit dhe kanë dhënë gjithmonë mbështetje të pakushtëzuar.
Mirënjohje pafund për Av.Bledar Fejzon, që ka qenë motorri dhe syri vëzhgues i rrugës shumë të vështirë të U.P. Gjithmonë aty për të dhënë zgjidhjet e duhura në dobi të psikologëve.
Falenderim për familjen time, që kanë mbështetur çdo hap timin për ngritjen e U.P., emocionalisht dhe financiarisht. Darios dhe Tomasit u kam marrë shumë kohë nga koha e tyre.
Falemnderit të gjithë atyre që janë gjithmonë të pakënaqur me punën e Urdhrit! MË BËNI TË PUNOJ MË SHUMË!

Rruga është e hapur për në EuroPsy!

Përzemërsisht,
Valbona Treska"

➢ Për herë të parë, **me urdhër të Ministres Ogerta Manastirliu më datë 31.07.2019, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik,** në përbërje të të cilit marrin pjesë një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dy përfaqësues të Urdhrit të Psikologut. Detyra e këtij komisioni është të

vlerësojë kryerjen e praktikës profesionale 1 vjeçare për të gjithë ata psikologë që e kanë përfunduar atë. Kalimi me sukses i provimit të praktikës profesionale është parakusht ligjor për kualifikimin për marrjen pjesë në provimin e shtetit me qëllim pajisjen me licencën profesionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETIT DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr.55.56 Prot
/

Tiranë, më 31.07.2019

URDHËR
Nr. 530 Datë 31.7.2019

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT E AFTËSIMIT PRAKTIK PËR PROFESIONIN E PSIKOLOGUT

Në zbatim të ligjit nr.40/2016 "Për ordinerin e psikologut në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionin e rregulluar të psikologut", i ndryshuar, vendimit nr.174/1, dt.07.09.2018 dhe Mësimit nr.xxxxx, Sportit dhe Rinisë nr. 418/2, dt.22.03.2018 "Për miratimin e rregullimit të praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në RSH", si dhe propozimit nga Urdhri i Psikologut për caktimin e anëtarëve në KVAP,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit për Vlerësimin e Aftësimit Praktik për profesionin e rregulluar të psikologut (KVAP),
2. Komisioni për Vlerësimin e aftësimit praktik do të jetë i përbërë si ndjekësi:
   - Aleksandra Puçi, përfaqësuese i MSHMS
   - Edvin Luma, përfaqësues i Urdhrit të Psikologut
   - Besnesi Fetoku, përfaqësues i Urdhrit të Psikologut
3. Komisioni KVAP ka për detyrë të realizojë vlerësimin e praktikës profesionale të psikologëve, në pajtueshmëri me ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin nr.174/1, dt.07.09.2018 "Miratim i Mësimit nr.xxxxx, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për caktimin e Rregullimeve ni Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në RSH".

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.1, Tiranë, Albania Tel: +355 4270178 www.shendetesia.gov.al

Gusht

➢ Gjatë muajit gusht puna ka vijuar me një **korrespondencë mjaft intensive me ministritë tona të linjës, për regjistrimin pranë Urdhrit, të psikologëve, të cilët, ndonëse plotësonin kriteret ligjore për të qenë anëtarë, ende nuk kishin kryer regjistrimet** dhe vazhdonin të punonin në kundërshtim me ligjin 40/2016.

Korrespondenca ka qenë veçanërisht aktive me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi gjatë pjesës së parë të vitit, kemi patur një numër shumë të lartë psikologësh të punësuar në sistemin arsimor publik të paanëtarësuar. Kjo ka qenë një problematikë e vazhduar dhe nisur nga këto kushte, Ministria e Arsimit ka marrë të gjitha masat për identifikimin e psikologëve të punësuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Po kështu gjatë këtij muaji janë ndërmarrë disa iniciativa nga vetë institucioni për të nisur kontrollet nga një grup task force për psikologët e punësuar në institucionet jo publike.

Shtator

➢ **Në datë 21 shtator Shqipëria u godit nga një tërmet 5.4 ballë.** Në kuadër të emergjencës dhe të dhënies së mbështetjes psiko-emocionale, Urdhri i Psikologut menjëherë u mobilzua për të krijuar grupin e psikologëve vullnetarë, që do të vinin në ndihmë të institucioneve publike dhe jo publike për menaxhimin e situtës. Ky ishte tërmeti më i forte në shumë vite, që goditi kryesisht qarkun e Tiranës e Durrësit, ndërsa komunitetet ishin të papërgatitur për këtë situatë.

Në **datë 23 shtator realizuam një takim në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Drejtorinë Arsimore Tiranë** dhe vumë në dispozicion të institucioneve një listë me 10 psikologë vullnetarë, të cilët sipas një grafiku të dakordësuar, u pozicionuan në shkolla të ndryshme të Qarkut Tiranë për të dhënë mbështetjen e tyre ndaj nxënësve dhe stafeve pedagogjike. Ndërkohë që, për të gjithë Shqipërinë, lista e vullnetarëve shkoi në disa dhjetra dhe data-base të specifikuara për çdo qark u vunë në dispozicion të ministrive të linjës si dhe institucioneve të pushtetit lokal.

Ishte hera e parë që psikologët bashkoheshin për të dhënë ndihmën e tyre në situata të tilla emergjence dhe, me sa duket, ky shëmbull i mirë i shtatorit u kthye në një mënyrë të konsoliduar pune edhe në tërmetin e fuqishëm të nëntorit.

Tetor

➢ Më datë 2 tetor 2019 **Urdhri i Psikologut organizoi ceremoninë e pritjes me rastin e anëtarësimit në Federatën Europiane të Psikologëve (EFPA).**

Kjo ishte një ceremoni suksesi, e cila jo vetëm bashkoi komunitetin e psikologëve, por bëri bashkë edhe figura të njohura të shoqërisë civile, institucioneve, ministrive të linjës dhe miq, të cilët kanë kontribuar që në krye të herës për ngritjen dhe fuqizimin e institucionit.

Dhe në këtë sukses të madh tonin, nuk mund të linim pa falenderuar dhe dhe shprehur mirënjohje simbolike nëpërmjet medaljeve të mirënjohjes për katër personalitete të politikës shqiptare, të cilët kanë dhënë ndihmë të jashtëzakonshme për Urdhrin e Psikologut gjatë këtyre viteve:

- Z.Erjon Veliaj, ish ministër i Çështjeve Sociale, aktualisht Kryetar i Bashkisë Tiranë, i cili inicioi hartimin e ligjit për Urdhrin e Psikologut,

- Z.Blendi Klosi, ish ministër i Çështjeve Sociale, i cili finalizoi me shumë sukses zbatimin e ligjit për Urdhrin e Psikologut duke organizuar Asamblenë Themeluese më 28 janar 2017 dhe duke i dhënë kështu rrugë zgjedhjes së organeve drejtuese dhe ngritjes së institucionit. Puna e bërë nga Z.Klosi dhe stafi i tij kanë qenë e

jashtëzakonshme dhe frymëzuese në fillimin e mbarë të punës tonë.

- Znj.Olta Xhaçka, ish Ministre e Çështjeve Sociale, aktualisht Ministre e Mbrojtjes, e cila edhe pse për një periudhë të shkurtër në drejtim të ministrisë që themeloi Urdhrin, firmosi për herë të parë marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve, me qëllim fillimin e procedurave për licencimin e psikologëve. Licencimi i psikologëve të parë në shtator 2017, pak muaj pas fillimit të punës së U.P., ka qenë ngjarje historike për profesionin.

- Znj.Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (autoriteti kompetent i U.P.), e cila ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetje e jashtëzakonshme për fuqizimin dhe mbarevajtjen e punës tonë.

Pa vullnetin dhe dashamirësinë e këtyre personaliteteve, nuk do të ishim në këtë stad të punës tonë, ndaj i gjithë komuniteti i psikologëve pati mundësinë t'u shprehë falenderimet në ceremoninë e pritjes që organizuam.

Në 2.5 vite të ndërtimit të institucionit punët kanë qenë të panumërta, sukseset të jashtëzakonshme dhe mbështetja ndaj njëri-tjetrit e

pakushtëzuar, ndaj kishim shumë arsye të festonim të gjithë së bashku më 2 tetor 2019.

➢ Puna e institucionit ka vijuar në tetor me **përgatitjet e pyetjeve të praktikës profesionale, për të gjithë ata psikologë që kishin përfunduar praktikën 1 vjeçare të supervizuar.** Tre grupime të rëndësishme të pytjeve për secilin psikolog, në një total prej 60 pyetjesh, u publikuan në bazë të legjislacionit në fuqi, për t'i hapur rrugën realizimit të provimit të parë të vlerësimit të praktikës profesionale.

➢ Kemi vazhduar gjatë këtij muaji takimet me grupe të studentëve të psikologjisë për të dhënë infromacion të nevojshëm mbi Urdhrin e Psikologut, procedurat për regjistrim dhe licencim. Në kuadër të dhënies së këtyre informacioneve, **ishim të ftuar në Universitetin Mesdhetar të Tiranës për një takim të hapur me studentët e këtij universiteti.**

➢ Po kështu, pas një pune intensive, gjatë këtij viti, i cili filloi me përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Edukimit në Vazhdim dhe më pas me plotësimin e dosjeve me dokumentacion nga institucionet që paraqiten interes për t'u akredituar, **më 30 tetor lancuam për herë të parë dy institucionet e para, të cilat me vendim të komisionit, do të realizonin në vijim trajnime të akredituar për psikologët.**
Ngritja dhe bërja funksional e sistemit të edukimit në vazhdim, është një prej sukseve të institucionit, që na siguron rritje profesionale të psikologëve me standarde të larta dhe përfitime të njohurive profesionale gjithmonë e më bashkëkohore.

Nëntor

Nëntori ka qenë muaji më intensiv i vitit, me aktivitete suksesi për U.P., por edhe me ngjarje tragjike siç ishte tërmeti i 26 Nëntorit.

➢ **Urdhri i Psikologut, i përfaqësuar nga Presidentja Valbona Treska, mori pjesë në Samitin Ndërkombëtar të Psikologjisë dhe Shëndetit Global: "Një Udhëheqës në Veprim mbi Klimën", i cili u mbajt në datat 14-16 Nëntor në Lisbonë, Portugali.**

Ky Samit bashkoi udhëheqës në fushën e psikologjisë nga gati 40 vende nga e gjithë bota për t'u përqëndruar në rritjen e rolit të psikologjisë në adresimin e problemeve të ndryshimit global të klimës, në mënyrë specifike për të ndihmuar në arritjen e Qëllimit

13 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm: "Të ndërmarrim veprime urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e saj".

Nën kujdesin e Francisco Rodrigues – President i Urdhrit të Psikologëve Portugezë dhe Arthur Evans – CEO i Shoqatës Psikologjike Amerikane (APA), në dy ditë intensive pune u mbajtën prezantime nga të ftuarit, u realizuan diskutime e grupe pune, si dhe u ndërtuan plane dhe u dhanë ide për rritjen e rolit të organizatave të secilit vend pjesëmarrës, në impaktin pozitiv që duhet të kenë në zbutjen e ndikimit negativ të ngrohjes globale.

Bashkë me 39 vende të tjera firmosëm gjithashtu në 15 nëntor "Deklaratën mbi Veprimtarinë e Psikologëve për Ngrohjen Globale".

Si pjesë e rëndësishme e takimeve të profesionistëve nga e gjithë bota, tashmë është fakt se Shqipëria nuk është një vend i panjohur në arenën ndërkombëtare, por mban një pozicion të stabilizuar të politikave botërore për psikologët.

- **Tërmeti i datës 26.11.2019**

Në datën 26.11.2019, në orën 03.45 të mëngjesit, Shqipëria u godit nga një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës Rihter, më i fuqishmi në vend prej 40 vitesh. Me mijëra ndërtesa u dëmtuan, me mijëra ishin personat që u lënduan fizikisht apo psikologjikisht. 51 të vdekur në të gjithë vendin, të cilët u nxorrën nga rrënojat nga ekipet e shëptimit, që erdhën në ndihmë nga disa vende të Europës.

Me mijra pasgoditje pasuan goditjen kryesore. Banesat dhe pallatet, vecanërisht në Tiranë, Durrës e qytete përreth, u boshatisën për ditë të tëra dhe njerëzit qëndruan të flinin në makina. Një situatë katastrofe, të cilën Shqipëria nuk e kishte përjetuar asnjëherë në këto përmasa.

Po atë ditë, vetëm pak orë pas ngjarjes, në orën 8.00 të mëngjesit, Presidentja e Urdhrit Valbona Treska ju drejtua me një mesazh sensibilizimi e solidariteti të gjithëve dhe në veçanti psikologëve. Po në orët e para të mëngjesit, u kërkua që psikologët kudo në Shqipëri të kontaktonin me koordinatorët për të dhënë ndihmën e tyre.

Gjatë ditës, Presidentja Treska anulloi udhëtimin që duhet të bënte në orët e para të datës 27 nëntor drejt Kievit, Ukrainë, për të marrë pjesë në mbledhjen e presidentëve të urdhrave të Europës, organizuar nga EFPA.

Udhëtimi kishte qenë i planifikuar muaj më parë, por ajo vlerësoi se puna personale dhe e gjithë ekipit që drejtonte, duhet të ishte gjatë këtyre ditëve më shumë se kurrë pranë çdo personi që ishte lënduar fizikisht dhe emocionalisht.

Gjendja i ngjante një lufte. Spitalet e Durrësit e rrugët ishin plot me të plagosur, mes të cilëve edhe fëmijë. Në Bashkinë Thumanë dy pallate me dhjetra banorë brenda u shembën, duke zënë poshtë me disa viktima, midis të cilëve edhe nga e njëjta familje.

Zyra qëndrore e Urdhrit të Psikologut u dëmtua shumë dhe u deshën javë që të riniste aktivitetin pas riparimeve, por e gjitha kjo nuk e pengoi institucionin të bashkohej për të dhënë shëmbullin e një uniteti të jashtëzakonshëm, për t'i ardhur në ndihmë kujtdo.

Edhe pse pa eksperiencë të mëparshme për të menaxhuar situata të tilla, në kohë rekord u aktvizuan pika kontakti të psikologëve në të gjithë vendin dhe, në ditën e tretë të ndihmës, ishin bashkuar 350 psikologë vullnetarë. Shtabi i Emergjencës me 15 psikologë në përbërjen e tij, koordinoi punën në 52 pika të ndryshme të vendit.

Pjesa më e madhe e të dëmtuarve të tërmetit u vendos fillimisht në çadra në Durrës, Thumanë, Lezhë, Vorë, Bubq e komuna të tjera, ndërkohë që në datë 28 nëntor nisi trasportimi i tyre në hotele, kryesisht në Durrës, Plazh e Shëngjin. Urdhri i Psikologut nuk e ndaloi punën në asnjë moment.

Kemi dhënë ndihmë me psikologët tanë fillimisht në çadra, ndërkohë që toka vazhdonte të kishte lëkundje të forta dhe pranë çadrave vazhdonin të nxirreshin trupa nga rrënojat.

Hotel "Rafaelo" në Shëngjin pati rreth 1000 të akomoduar, të cilët u asistuan me turne nga psikologë, jo vetëm nga Lezha, por edhe nga Shkodra e zonat përreth, që udhëtuan çdo ditë për të qenë pranë tyre. Koordinatori ynë i Lezhës Z.Besmir Frroku koordinoi të gjithë punën në terren.

Organizimi i Koordinatorit të Durrësit Z.Elton Kuqja për mijra të dëmtuar të akomoduar në hotelet e Durrësit, ka qënë pa ndërprerje edhe gjatë natës. Për ditë të tëra psikologët qëndruan edhe pa u kthyer në shtëpitë e tyre, me qëllim që të ndihmonin sa të mundnin. Grupe nga Shkodra, nën drejtimin e koordinatorit të Shkodrës Z.Altin Nika, si dhe nga Kosova, ju bashkuan kolegëve të Durrësit, Vorës e Shëngjinit, për t'i zëvendësuar në turnet e tejzgjatura që kryenin.

Çdo darkë, që prej datës 27 nëntor 2019 e për ditë me rradhë, u kujdesëm të përçonim informacion në kohë reale për të dëmtuarit dhe nevojat e tyre, pranë institucioneve përgjegjëse.

Në dy ditët e para raportet përmbanin shifra të përgjithshme për të dëmtuarit, pikat ku ishin vendosur dhe numrin e psikologëve që po i asistonin, për t'u detajuar në ditët në vazhdim me shifra të sakta mbi numrin e fëmijëve, moshën e tyre, numrin e të rriturve të specifikuar në femra dhe meshkuj, numrin e personave me nevoja të veçanta dhe numrin e psikologëve që i asistonte.

Në të gjithë këtë situatë, institucioni u përkujdes maksimalisht, jo vetëm që të asistonte drejtëpërdrejtë personat e dëmtuar, por edhe të ishte prezent kohë pas kohe thuajse në të gjitha televizionet kombëtare, me qëllim qetësimin e popullatës.

Znj.Treska për ditë të tëra koordinoi të gjithë shërbimin psikologjik në rang vendi, në kushte shumë të vështira fizike dhe infrastrukture, pasi netët e para ajo dhe pjesëtarë të tjerë të stafit fjetën në makina dhe ndërkohë puna kompjuterike u realizua po në makinat e stafit, apo bare dhe vende ku ishin pozicionuar të dëmtuarit.

Psikologëve i'u shpërndanë në gjuhën shqipe materiale të OBSH mbi ndihmën e parë psikologjike, të përkthyera nga kolegët tanë kosovarë dhe Qëndra e Shërbimeve Psikologjike Shkodër. Po kështu, për secilin psikolog, u shpërndanë kartela për të mbajtur të dhëna të sakta për çdo të dëmtuar që asistonin.

Nga data 2 dhjetor nisi një koordinim më i plotë edhe nga Organizatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Jo Fitimprurëse në vend.

Pas rreth 2 javësh pune intensive në terren dhe koordinimit në rang vendi, një pjesë e psikologëve që vijuan punën, u pozicionuan pranë organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve, për të punuar në ndihmë të të prekurve nga tërmeti. Në ditët e para të dhjetorit kemi firmosur 5 marrëveshje bashkëpunimi për përfshirjen e psikologëve të Urdhrit të Psikologut në programet e këtyre organizatave, kundrejt një pagese për shërbimin që ofronin.

Një pjesë tjetër e psikologëve vullnetarë, që i'u bashkuan thirrjes sonë për më shumë se dy javë, i'u desh të shkëputeshin për t'u rikthyer në vendet e tyre të punës dhe vijuan të ofronin ndihmën e tyre vullnetare kohë pas kohe.
Ndonëse shërbimi nisi dhe u zhvillua për më shumë se dy javë në mënyrë vullnetare, organizmat kombëtare e ndërkombëtarë, duke vlerësuar maksimalisht punën e realizuar nga profesionistët e U.P., punësuan në strukturat e tyre rreth 63 psikologë me kohë të plotë apo të pjesshme.

Tërmeti i 26 nëntorit u kthye në një situatë force dhe triumfi për të gjithë komunitetin e psikologëve lidhur me shërbimet dhe sensibilitetin që përçuan.

Dhjetor

Në pjesën e parë të muajit vijuam të angazhoheshim me menaxhimin e situatës së shkaktuar nga tërmeti. **Vijuam koordinimin e grupeve tona në terren dhe përçuam informacione për shërbimet që vazhdonim të ofronim për thuajse të gjitha institucionet në vend**.
Zyra e Urdhrit të Psikologut u bë gati për të rinisur punën në mes të dhjetorit, pasi dëmtimet ishin të shumta. Edhe pse kemi patur një muaj shumë të ngarkuar fizikisht dhe psikologjikisht, për shkak të angazhimeve të shumta me tërmetin, menjëherë sapo kemi bërë funksionale

zyrat, kemi vijuar punën normalisht me korespondencat institucionale, si dhe me problematikat e përditshme, mbledhjet, si dhe përgatitjet për fillimin e vitit 2020.

Fundviti i Urdhrit të Psikologut, ndër të tjera, është i ngarkuar edhe për shkak të mbylljes së bilanceve financiare, hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës dhe mbledhjeve të Këshillit Kombëtar.

➢ Gjatë dhjetorit kemi realizuar edhe një ***takim me studentët e psikologjisë së Universitetit "Marin Barlet" me qëllim afrimin e tyre me procedurat e regjistrimit dhe licencimit në Urdhër.***

Gjatë këtij takimi u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi mes dy institucioneve, duke e zgjeruar kështu numrin e marrëveshjeve të firmosura mes Urdhrit dhe universiteteve të ndryshme publike dhe jopublike në vend.

➢ **Fundviti i aktiviteteve tona nuk mund të ishte tjetër veçse i gëzueshëm, pasi përfundoi me një tur të Presidentes Treska në zonat e prekura nga tërmeti i 26 Nëntorit**, tashmë jo për të asistuar të dëmtuarit, por **për të trokitur gotat e fundvitit dhe për t'i thënë faleminderit çdo psikologu që ju bashkua nismës vullnetare për të prekurit**, dhe që për ditë me rradhë harroi familjen, me qëllim ofrimin e shërbimeve për mijra veta që gjendeshin në situata shock-u emocional dhe paniku.

➢ Në vazhdën e identifikimit të profesionistëve që lanë gjurmë këtë vit në profesion, vlerësuam se puna më e madhe dhe e çmuar, u dha nga grupi i madh i psikologëve në tërmetin e 26 nëntorit.

Çmimi i përvitshëm "Psikologu i vitit 2019" nuk mund t'i jepej një individi! Ishin plot 81 psikologë profesionistë, anëtarë të U.P., të cilët lanë pas traumën që ata vetë përjetuan dhe vullnetarisht punuan në ditët e para në terren, që prej datës 26 nëntor, për ti dhënë ndihmë të dëmtuarve.

Së bashku me Shtabin e Emergjencës, nga grupi i madh prej rreth 350 psikologësh që dhanë ndihmë, kemi identifikuar secilin prej tyre, që i'u pergjigj thirrjes tone që në ditën e parë.

Çmimi "Psikologu i Vitit" këtë vit ju dha secilit prej tyre, që dëshmuan forcë njerëzore dhe profesionale në situatën më të vështirë që kishte kaluar vendi në dekadat e fundit.

Viti 2019 nuk mund të mbyllej më bukur se kaq, me çdo njërin prej tyre në foto, që ishin pjesë e emergjencës.

Ata, të gjithë bashkë, të 81 psikologët që ju përgjigjen thirrjes tonë që në ditën e parë, të gjithë bashkë ishin "Psikologu i Vitit"!

Ne kemi patur një vit plot suksese e sfida dhe jemi krenarë jo vetëm për këtë grup psikologësh, por për çdo psikolog, që ndonëse nuk ishte me ne për emergjencën e tërmetit, punon me shpirt e përkushtim çdo ditë të vitit dhe i shton vlerat profesionit.

2. ORGANET E URDHRIT TË PSIKOLOGUT DHE AKTIVITETI I TYRE FUNKSIONAL

Organet kryesore të Urdhrit të Psikologut janë:

a) Asambleja Kombëtare;
b) Këshilli Kombëtar;
c) Presidenti i Urdhrit;
ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional
d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim
e) Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht Komisioni i Licencimit dhe Komisioni i Praktikave Profesionale.

Organigrama e Urdhrit të Psikologut



2.1 Asambleja Kombëtare

Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr. 40/2016, është Asambleja Kombëtare.

Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.

Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

- zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të gjithë anëtarëve të saj;
- miraton statutin e Urdhrit;
- miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
- miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;

- miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
- shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale tre vjeçare.

Këtë vit, **në datë 22.02.2019, në mjediset e Hotel "Koçibelli", në Korçë, u organizua Asambleja e 3-të Kombëtare e Urdhrit të Psikologut**, në të cilën morën pjesë 78 anëtarë, me rend dite si më poshtë:

- Hapja e punimeve nga Z.Igli Çutra, jurist i Urdhrit te Psikologut
- Fjalë përshëndetëse e koordinatorit lokal të qarkut të Korçës Z.Andi Petro
- Përshëndetja e Presidentes së Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska dhe analiza vjetore e punës së organeve të këtij institucioni
- Analizë e punës vjetore të Komisionit të Etikës, rastet e shqyrtuara, problematikat e hasura nga Z.Edvin Lame
- Analizë e situatës financiare të vitit 2018 dhe prezantim i projekt-buxhetit të vitit financiar 2019 nga financieri i Urdhrit të Psikologut, Z.Lejdi Goga
- Miratimi i buxhetit faktik të vitit 2018, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut Vendimi Nr 2, datë 05.02.2019
- Miratimi i projekt-buxhetit të vitit 2019, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut Vendimi Nr 12, datë 21.12.2018
- Hapësirë e lirë për diskutime.

Asambleja u zhvillua me sukses dhe me diskutime konstruktive, duke miratuar të gjithë pikat e rendit të ditës

Asambleja e III-të Kombëtare mori vendim:
- të miratojë Buxhetin Faktik të vitit 2018, me 77 vota pro dhe 1 kundër të anëtarëve prezent në Asamble.
- të miratojë Projekt-Buxhetin e vitit 2019, me 77 vota pro dhe 1 kundër të anëtarëve prezent në Asamble.

2.2 Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 17 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:

Dr.Blerta Bodinaku
Dr.Fleura Shkëmbi
Dr.Brunilda Laboviti
Dr.Valbona Habili
Elona Mustafaraj
Dr.Skerdi Zahaj
Rezarta Basha
Gracela Mana
Sonila Meçaj
Denada Toçe
Redina Balla

Në përbërjë të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministritë, përkatësisht nga:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale *(njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit):*
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Mbrojtjes

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:
a) miraton strukturën e vet organizative;
b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;
dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
e) ngre grupe pune ad-hoc për kryerjen e kontrolleve në ushtrimin e profesionit të psikologut;
ë) përgatit publikon raportin vjetor dhe financiar.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti, ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur.

Gjatë vitit 2019 Këshilli Kombëtar ka marrë vendimet e mëposhtëme:

- Vendim Nr.1, dt.05.02.2019, " Për miratimin e Raportit vjetor 2018"
- Vendim Nr.2, dt.05.02.2019, "Për miratimin e Buxhetit Faktik 2018"
- Vendim Nr.3, dt.26.04.2019, "Për miratimin e tarifave financiare për shërbime administrative"
- Vendim Nr.4, dt.26.04.2019, "Për ngritjen e një komisioni ad-hoc për

shqyrtimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit të Etikës"

- Vendim Nr.5, dt.03.05.2019, "Për miratimin e profileve të psikologjisë për organizimin e provimit të shtetit"
- Vendim Nr.6, dt.03.05.2019, "Për rikthimin për rigjykim në Komisionin e Etikës dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional të çështjes disiplinore"
- Vendim Nr.7, dt.30.07.2019, "Për ngritjen e komisionit ad-hoc për shqyrtimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit të Etikës"
- Vendim Nr.8, dt.18.09.2019, "Për rrëzimin e Vendimit Nr.8, dt.18.07.2019, të Komisionit të Etikës dhe dhënien e masës disiplinore"
- Vendim Nr.9, dt.18.09.2019, "Për vijimin e shqyrtimi të çështjes disiplinore, duke thirrur palët në seancë dëgjimore në Këshillin Kombëtar"
- Vendim Nr.10, dt.18.09.2019, "Për ngritjen e një komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit të Etikës"
- Vendim Nr.11, dt.18.09.2019 "Për zgjedhjen në cilësinë e anëtarit zëvendësues të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor e Profesional, Znj.Marta Bej"
- Vendim Nr.12, dt.15.10.2019, "Për ndryshimin e Vendimit Nr.6, dt.13.06.2019 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional"
- Vendim Nr.13, dt.15.10.2019, "Për lënien në fuqi të Vendimit Nr.7, dt.18.07.2019, të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional"
- Vendim Nr.14, dt.06.11.2019, "Për miratimin e tarifave të provimit të VAP dhe anëtarit të KVAP".

2.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut ".

Komisioni Etikës Gjykimit Disiplinor e Profesional ka në strukturën e tij 5 anëtarë me një eksperiencë pune mbi 10-vjecare në profesion:

Dr.Jonida Haxhiu,
Dr.Migena Buka,
Dr.Stela Dhima,
Dr.Lediana Xhakollari,
Dr.Edvin Lame, (deri në datën 18.09.2019, datë në të cilën ka dhënë dorëheqjen për arsye personale), i zëvendësuar aktualisht me:
Dr.Marta Bej (zgjedhur me mandat zëvendësues me vendim Nr.11, datë 18.09.2019 të Këshillit Kombëtar).

Komisioni funksionon në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë si dhe Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional. Gjatë vitit 2019 Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar 10 raste, të iniciuara nga individë të ndryshëm ose edhe kryesisht nga Presidentja e Urdhrit, për raste sensitive që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Komisioni i Etikës, pas shqyrtimit të rasteveka dhënë këto vendime:

- Në 6 raste janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës dhe janë dhënë masa të ndryshme disiplinore kundrejt psikologëve të tilla si: vërejtje me paralajmërim; vërejtje me shkrim; gjobë; përjashtim nga UP për një periudhë 3 deri në 18 mujore.
- Në 3 raste, pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni Etik nuk ka konstatuar raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ndaj kërkesa e palëve ankuese është rrëzuar.
- Në 1 rast është dhënë një vendim i ndërmjetëm: Pezullim i gjykimit të çështjes, deri në përfundimin e procesit penal.

Gjatë punës së Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor në vitin 2019 janë hasur edhe problematika që kanë të bëjnë më uniformitetin dhe kohezonin në gjykimin e rasteve, respektimin e afateve proceduriale, arsyetimin e vendimeve, etj., të cilat janë trajtuar në disa mbledhje të veçanta të thirrura nga Presidentja e Urdhrit, si dhe në mbledhje të veçanta të Këshillit Kombëtar të Urdhrit.

Në disa raste, vendimet e këtij komisioni janë prishur dhe ndryshuar nga Këshilli Kombëtar, i cili shqyrton çështjet disiplinore si shkallë më e lartë gjykimi.

Këshilli Kombëtar ka vendosur t'i adresojë këto problematika duke bërë ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional, duke përfshirë në Komisionin e Etikës një jurist nga administrata e Urdhrit të Psikolout, i cili në të ardhmen do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së komisionit nga ana proceduriale dhe do të rrisë cilësinë e gjykimit.

2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji

Ky Komision zgjidhet nga Këshilli Kombëtar dhe drejtohet nga Presidenti i Urdhrit.

Në përbërje të tij janë edhe anëtarët e mëposhtëm:

Prof.Dr.Theodhori Karaj,
Prof.As.Dr.Zenel Orhani,
Prof.As.Dr.Erika Mellonashi
Dr.Marsela Shehu.

Pas krijimit të tij një vit më parë, dhe pas plotësimit të të gjitha akteve

normative që e bën atë të jetë funksional, ky Komision vijoi punën normalisht gjatë vitit 2019, duke shqyrtuar aplikimet e para për akreditim të subjekteve, të cilat ishin të interesuara të kryenin aktivitete të akredituara të edukimit në vazhdim në psikologji. Gjatë vitit 2019 nga ky komision janë marrë vendimet e mëposhtme:

1. Vendimi Nr.1, datë 16.09.2019

a) "Të akreditojë si ofrues shërbimesh në fushën e edukimit në vazhdim në psikologji Institucionin "Qendra e Shërbimeve Psikologjike", Shkodër me afat të përkohshëm 12 muaj, pasi vlerësoi se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.

b) Të akreditojë si ofrues shërbimesh në fushën e edukimit në vazhdim në psikologji Institucionin "Inner Life", Tiranë me afat të përkohshëm 12 muaj, pasi vlerësoi se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.

2. Vendimi Nr.2, datë 29.10.2019

a) Të akreditojë Aktivitietin e "Qendrës së Shërbimeve Psikologjike", Shkodër, me titull: "*Shëndeti mendor dhe mirëqenia psikologjike e fëmijës*", në vlerën e 10 krediteve.

b) Të akreditojë Aktivitetin e "Qendrës së Shërbimeve Psikologjike" Shkodër, me titull: *"Prindërimi pozitiv në fokus fëmijën nga 0-12 vjeç",* në vlerën e 10 krediteve.

c) Të akreditojë Aktivitetin e "Qendrës së Shërbimeve Psikologjike", Shkodër, me titull: *"Ndërhyrjet psikologjike te fëmijët dhe adoleshentët: Trajtimi i shëndetit mendor sipas prespektivës me familjen në qendër",* në vlerën e 10 krediteve.

d) Të akreditojë Aktivitetin e Institucionit "Inner Life", Tiranë, me titull: *"Meditimi Mindfulness në trajtimin e stresit dhe ankthit",* në vlerën e 12 krediteve.

e) Të akreditojë Aktivitetin e Institucionit "Inner Life", Tiranë, Moduli I me titull: *"Analiza deskriptive inferenciale dhe cilësore e të dhënave në kërkim shkencor*", në vlerën e 18 krediteve dhe Modulin II, me titull: *"Metodat e kërkimit sasior dhe cilësor në shkencat sociale",* në vlerën e 12 krediteve.

2.5 Administrata e Urdhrit të Psikologu

Administrata e Urdhrit të Psikologut përbëhet nga:

Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra

Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga

Sekretariati, Protokolli, Arshiva – një punonjëse, Znj.Armira Baboçi

Igli ÇUTRA

Armira BABOÇI

Lejdi GOGA

2.6 Komisione të tjera

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

2.6.1 Komisioni i Licencimit

Ky Komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe shqyrton kërkesat për licencim të të gjithë atyre psikologëve, që në bazë të ligjit dhe akteve normative në fuqi, përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe provimit të shtetit.

Ai përbëhet nga Presidentja Znj.Valbona Treska, juristi Z.Igli Çutra, si dhe nga anëtarët e Keshillit Kombëtar: Dr.Skerdi Zahaj, Znj.Sonila Meçaj dhe Znj.Graciela Mana.

Gjatë vitit 2019 ky komision ka licencuar 71 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtëme:

Psikologë klinikë - 32 anëtarë

Psikologë shkollorë dhe organizacionalë - 14 anëtarë

Psikologë këshillimi - 9 anëtarë

Psikologë të përgjithshëm - 6 anëtarë

Psikologë shkollorë- 3 anëtarë

Psikologë në institucione - 3 anëtarë

Psikologë ligjorë - 2 anëtarë

Psikologë në orientim profesional - 2 anëtarë

Psikologë organizacionalë - 2 anëtarë

Psikologë në kërkim psikologjik - 2 anëtar

2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Ky komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar për efekt të zbatimit të "Rregullores së Praktikës Profesionale", e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoritetit kompetent, e cila mundëson rregullimin ligjor të vijimit të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr.Brunilda Laboviti, Znj.Redina Balla, Znj.Aleksandra Puçi, si dhe nga juristi i Urdhrit të Psikologut, Z.Igli Çutra.

Këtë vit janë regjistruar pranë Urdhrit të Psikologut 123 praktikantë me kontrata të rregullta punësimi në institucione të ndryshme shtetërore e private. Komisioni i Praktikës ka shqyrtuar gjatë vitit 2019 dosjet e 77 psikologëve dhe, pas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

- 18 psikologë të perjashtohen nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes U.P dhe MSHMS
- 29 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikë të pjesshme profesionale.
- 30 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikën e plotë profesionale.

2.7 Koordinatorët Lokal

Ky rrjet ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të rajonit përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat, që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të psikologut.

Koordinatori lokal ka si mision:

- kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specific, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyrë shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në rajon
- vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut.

Disa nga funksionet që kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës, përsa i përket procedurës së anëtarësim-liçensimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet publike, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.

- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut.
- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.

Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psikologut, me qëllim inicimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Gjatë vitit 2019, rrjetit të koordinatorëve lokalë të Urdhrit të psikologut iu shtua koordinatorja për qarkun e Fierit dhe koordinatori për qarkun e Durrësit. Aktualisht, shpërndarja e rrjetit të koordinatorëve është si më poshtë:

➢ **Koordinatori Lokal për Qarkun e Shkodrës**

Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike, me Drejtor Ekzekutiv,
Z.Altin Nika
Adresa: Rruga Hysej, Dugajet e Reja, ish-godina e shkollës "Zani Shkodrës"
Tel.: 0684420000
e-mail: altinnika@yahoo.com

➢ **Koordinatori Lokal për Qarkun e Lezhës:**

Z.Besmir Frroku
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Godina Nr.4, Kati 2, Lezhë
Tel.: 0693930434
e-mail: besmir.frroku@hotmail.com

➢ **Koordinatori Lokal për Qarkun e Korçës:**

Z.Andi Petro
Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë
Tel.: 0695303133
e-mail: andipetro.al@gmail.com

➢ **Koordinatori Lokal për Qarkun e Fierit:**

Znj.Silvana Duka
Adresa: Lagjia"29 Nentori", Rr: "Pinellopi Pirro", Pall: "Arditi 06" (mbi Ecomarket), Kati I 3-të, Qendra "Epoka e re", Fier
Tel.: 0692436900
e-mail: silvi_kostrica@yahoo.com

➢ **Koordinatori Lokal për Qarkun e Durrësit:**

Z.Elton Kuqja
Adresa: Rr. "Sefer Efendiu", Objekt 22/11, Durrës
Tel.: 0693110878
e-mail: elton_kuqja@yahoo.it.

3. ANËTARËSIA E URDHRIT TË PSIKOLOGUT

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të kenë diplomën e studimeve të larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

- të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2019, por ende ka vend për zgjerim. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese kundrejt psikologëve, por edhe kundrejt institucioneve publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut ka arritur deri më sot **914 anëtarë** të regjistruar.

3.1 Psikologë të licencuar

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përjashtimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.

Në këto kushte, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri ka vijuar procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në R.Sh"[1] dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

[1] Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" (i nyshuar), pika 4.:Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;

Aktualisht , licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës paraqitet si më poshtë:

Psikologë të licencuar sipas viteve	2017	2018	2019	Total
Total të Licencuar	**307**	**175**	**71**	**553**
Psikologë Klinikë	147	97	32	276
Psikologë Shkollorë Organizacionalë	48	19	14	81
Psikologë Shkollorë	28	14	3	45
Psikologë Organizacionalë	8	13	2	23
Psikologë në Institucione	17	6	3	26
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	2	14
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	9	75
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	2	9
Psikologë Ligjorë	5	2	2	9
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	6	16
Psikologë Komuniteti	2	-	-	2
Psikologë në Rehabilitim psikologjik	1	-	-	1

4. NDËRTIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK ONLINE

Një nga detyrat ligjore të Këshillit Kombëtar është ngritja dhe ndërtimi i një regjistri elektronik on-line, në të cilin të pasqyrohetn të dhënat e aksesueshme për publikun për çdo psikolog. Ky proces ka filluar prej me shumë se një viti dhe aktualisht është në fazën përfundimtare të tij për plotësimin e të dhënave.

Ky regjistër është ndërtuar në formën e një platforme dhe përmban të dhënat identifikuese profesionale për secilin psikolog. Regjistri është ndërtuar të funksionojë në dy sisteme. Në sistemin elektronik përfshihet çdo e dhënë për psikologët anëtarë, ndërkohë që online publikohen e janë të dukshme vetëm të dhëna të domosdoshme për publikun, të cilat mund të aksesohen nga vetë ata apo të interesuarit.

Regjistri online i publikuar është i ndarë në këto rubrika: numri identifikues për çdo të anëtarësuar, emri/mbiemri, vendbanimi dhe numri i kontaktit ose në mungesë adresa e postës elektronike. Vendbanimi është një e dhënë e domosdoshme në mënyrë që të interesuarit të identifikojnë psikologët që ushtrojnë profesionin pranë vendbanimeve të tyre për të marrë shërbim më të shpejtë kur u nevojitet.

Për më tepër, në platformën e re të ndërtuar, mundësohet që të ruhet në mënyrë të dixhitalizuar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga psikologu pranë Urdhrit të Psikologut, si dhe çdo e dhënë që lidhet me jetën e tij profesionale, si dhe me procesin e licencimit dhe të rilicencimit. Në regjistër do të pasqyrohet edhe sasia e krediteve të marra nga çdo psikolog në kuadër të edukimit në vazhdim, dhe ndarja e tyre sipas fushës së mbuluar të aktivitetit.

5. RRUGA DREJT PROVIMIT TË PARË TË SHTETIT PËR PROFESIONIN E PSIKOLOGUT

Urdhri i Psikologut, si institucion i përcaktuar me ligj për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të psikologut, ka nisur që me krijimin e tij, në mars 2017, korrespondencë aktive dhe takimet me ministritë e linjës dhe institucione të tjera, për dhënien e licencave profesionale për kategorinë e psikologëve, që përjashtohej nga detyrimi për të dhënë provimin e shteti dhe, njëkohësisht, realizimin e provimit të parë të shtetit, që do t'i hapte rrugën licencimit të psikologëve të diplomuar pas hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë".

Me insistimin dhe përkushtimin maksimal, Urdhri i Psikologut, në vetëm pak muaj, ka mundësuar shpërndarjen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë të Lejeve Individuale të Ushtrimit të Profesionit të Psikologut (Licencave Profesionale), për të gjithë atë kategori psikologësh të cilët kishin përfunduar të dy ciklet e studimit përpara hyrjes në fuqi të *Ligjit 40/2016*, si dhe kishin ushtruar

profesionin e psikologut në mënyrë të rregullt përpara hyrjes në fuqi të ligjit, për të paktën 1 vit.

Me qëllim që të bëhej i mundur fillimi i këtyre licencimeve, u nënshkrua midis Urdhrit të Psikologut dhe ish Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë "Memorandumi i Bashkëpunimit", datë 19.05.2017 me nr.22 prot, akti i cili mundësoi licencimin e kësaj kategorie të psikologëve. Deri tani, bazuar në këtë akt, janë licencuar 553 psikologë.

Në lidhje me psikologët, të cilët kanë përfunduar studimet pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe duhet të japin provimin e shtetit, si akt final për licencim, institucioni ka ndjekur të gjitha hapat për realizimin e këtij procesi, i cili në vetvete ***ka qenë një proces kompleks***. Përpara kryerjes së provimit të shtetit, bazuar në ligjin *Nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", e* gjithë kjo kategori psikologësh, duhet të kryejë një vit praktikë profesionale nën supervizim dhe duhet t'i nënshtrohen provimit të Vlerësimit të Aftësimit Praktik.

E gjithë procedura sa më sipër nuk kryhet në mënyrë autonome nga Urdhri i Psikologut, por duhet të bazohet mbi akte nënligjorë të nxjerra nga autoriteti kompetent (sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshilli i Ministrave.

5.1 Procedurat ligjore, konsultimet, takimet formale e informale, lobimet dhe korrespondenca institucionale shkresore dhe elektronike, me qëllim përfundimin e procesit.

Urdhri i Psikologut, që në fillim të punës së tij, ka ndjekur me vëmendje maksimale këtë proces dhe, deri më sot, në bashkëpunim me autoritetin competent, janë hedhur hapat e mëposhtëm:

1. Fillimisht u nënshkrua *Urdhri i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr.418/2 prot, në datë 22.01.2018 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.574/1 Prot, datë 30.01.2018* ***"Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të psikologut në Republikën e Shqipërisë",*** i cili i hapi rrugën për herë të parë të gjithë psikologëve që të kryejnë Praktikën Profesionale të Psikologut, në institucionet publike e private, si një nga parakushtet e ligjit për t'u pajisur me licencë. Aktualisht ushtrojnë profesionin në statusin e praktikantit rreth 400 psikologë.

2. Më pas u nënshkrua *Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Urdhrit të Psikologut dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në datë 17.05.2018*, ku në nenin 5 sanksionohet **përjashtimi nga kryerja e praktikës profesionale,**

për t'i ardhur në ndihmë kategorisë së psikologëve, të cilët e kanë ushtruar profesionin e psikologut për të paktën një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit, në mënyrë që të mos i nënshtrohen ushtrimit të praktikës profesionale, por të kryejnë vetëm provimin e shtetit, për t'u pajisur me licencë. Aktualisht janë përjashtuar nga kryerja e plotë e praktikës profesionale rreth 60 psikologë.

3. Në vijim të procedurave u bë e mundur dalja e *Urdhrit të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtes Sociale* ***"Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Aftësimit Praktik (KVAP)",*** *me Nr.580, datë 31.07.2019".* Në bazë të legjislacionit në fuqi, ky komision u ngrit për të vlerësuar praktikat profesionale, të kryera nga ana e psikologëve praktikantë, të cilët në rast të një vlerësimi pozitiv, kalojnë më pas në fazën e kryerjes së provimit të shtetit, në mënyrë që të pajisen me licencë. Mbi bazën e këtij akti, u ngrit ky komision dhe u publikua fondi i pyetjeve. U vendos një afat deri në datë 08.11.2019 për regjistrim në Vlerësimin e Aftësimit Praktik të psikologëve, që kishin përfunduar praktikën profesionale. Data e dhënies së provimit u shty nga dhjetori 2019 në janar 2020, për shkak të tërmetit të 26 nëntorit.

Njëkohësisht me kryerjen e këtyre detyrimeve, kemi tentuar dhe punuar vazhdimisht që të miratonim edhe aktet e tjera nënligjore të domosdoshme, që do t'i hapnin përfundimisht rrugë hartimit të pyetjeve nga Q.SH.A (Qëndra Kombëtare e Provimeve) dhe realizmin e provimit të shtetit.

Në këto kushte, institucioni ka ndjekur me prioritet procesin e përcjelljes së informacionit për realizimin e provimit të parë të shtetit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale drejt Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, nstitucione këto që konstatuan se duhet detyrimisht miratimi i një Vendimi të Këshillit të Ministrave për kategorizimin e specialiteteve dhe nënspecialiteteve të psikologjisë.

Hartimi i *Projekt – V.K.M "Për një shtesë në vendimin nr.649, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara të vendimit nr.649, datë 14.09.2011 të Këshillit të Ministrave*, është parakusht për organizimin e provimit të shtetit.

➢ Bazuar mbi shkresën nr.1956/1 prot., dt. 15.04.2019, të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë, për realizimin e provimit të parë të shtetit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë **ka konfirmuar nisjen e procedurave për miratimin e V.K.M.-së përkatëse, për kategorizimin e specialiteteve të psikologjisë, që i hap rrugën organizimit të provimit të parë të shtetit.**

Urdhri i Psikologut ka qënë nxitësi kryesor për hartimin dhe kryerjen e dëgjesave publike lidhur me këtë Projekt-V.K.M. Miratimi i kësaj V.K.M-je është shumë i rëndësishëm për

hartimin e provimit të shtetit për psikologët, në funksion të hartimit të pyetjeve të kategorizuara sipas profileve përkatëse, ndaj miratimi i saj do t'i hap rrugë ndërtimit të fondit të pyetjeve dhe organizimit të provimit.

➢ Në kuadër të aktivitetit tonë, me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi, vetë Urdhri i Psikologut ka patur një sërë konsultash me Ministrinë e Arsimit si dhe me Ministrinë e Shëndetësisë. Pas konsultimeve dhe identifikimit të me shume se 20 titujve të ndryshëm masterash profesionalë dhe shkencorë në psikologji, të kryer nga psikologët gjatë këtyre viteve në universitetet publike dhe private, në konsultim edhe me Ministrinë e Arsimit, u mblodh Këshilli Kombëtar i Urdhri të Psikologut, për të grupuar masterat aktual në grupe më të mëdha (specialitete), në bazë të kurrikulës të secilit prej tyre. **Grupimi i tyre në specialitete më të mëdha, bëhej me qëllim lëhtesimin në realizimin e provimit të shtetit, pasi hartimi i fondit të pyetjeve për rreth 20 lloje të ndryshme drejtimesh master, është praktikisht i pamundur!**

Këshilli Kombëtar i Urdhrit përbëhet nga 4 përfaqësues të ministrive të Arsimit, Shëndetësisë, Drejtësisë dhe Mbrojtjes, si dhe nga përfaqësues të botës akademike, përfshirë këtu edhe Universitetin e Tiranës.

➢ Pas përcaktimit të specialiteteve nga Këshilli Kombëtar, për të patur një proces të hapur e gjithëpërfshirës, në qershor 2019 realizuam një takim pune me grupet e interesit, në të cilin ishin prezent përfaqësues të të gjitha universiteteve publike dhe jo publike që kanë departamente të psikologjisë, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit.

Gjatë këtij takimi u konsolidua dakordësimi për nenspecialitetet që ishin propozuar. Materialet përkatëse nga ky takim i'u dërguan me shkresë zyrtare Ministrisë së Arsimit. Vlen të theksohet se gjatë të gjithë këtij procesi, specialistë të Ministrisë së Arsimit kanë qenë përkrahës për grupimin e llojeve të ndryshëm të masterave në psikologji në specialitete, sipas fushave përkatëse të psikologjisë.

➢ Në vijim të konsultave është kërkuar një tjetër takim nga Ministria e Arsimit, së bashku me përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Durrësit. Përfaqësuesi i Fakultetit të Shkencave Sociale, shef i departamentit të psikologjisë. Z.Theodhori Karaj, sërish ka dakordësuar me kategorizimin e 5 specialiteteve në psikologji, që ishin

propozuar nga Këshilli Kombëtar I Urdhrit të Psikologut. Specialitetet e ridakordësuara në takim, i janë dërguar sërisht zyrtarisht me shkresë përcjellëse nga Urdhri i Psikologut, Ministrisë së Arsimit.

➢ Në vijim të procedurave për provimin e parë të shtetit, **në dhjetor 2019, Zyra Juridike e Ministrisë së Shëndetësisë, pas kërkesës së Ministrisë së Arsimit për mendim mbi këto 5 specialitete të propozuara, ka dërguar përgjigje pranë Ministrisë së Arsimit duke specifikuar se, i sheh me vend keto 5 specialitete të psikologjisë dhe dakordëson për projekt-vendimin e propozuar.**

➢ Pas kësaj përgjigje, **serish nga Ministria e Arsimit i është kërkuar mendim me shkrim Fakultetit të Shkencave Sociale, Tiranë**, institucion i cili, edhe pse ka qenë prezent me përfaqësues të tij në të gjithë procesin e konsultimit, hodhi poshtë thuajse të gjithë konsultimet dhe vendimet e marra deri më tani dhe **propozoi specialitete të ndryshme nga ato që ishin dakordësuar në rang institucionesh e universitetesh publike e jo publike për gati një vit kalendarik.**

Në këndvështrimin tonë, ky qëndrim i Fakultetit të Shkencave Sociale, jo vetëm që nuk ishte serioz e koherent në qëndrim, por solli si pasojë edhe një ngërç dhe zvarritje të panevojshme në përpilimin përfundimtar të Projekt – V.K.M "Për një shtesë në vendimin nr.649, datë 14.09.2011, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara".

➢ Në bazë të shkresës së FSHS të UT, Ministria e Arsimit kërkoi mendimin tonë përfundimtar lidhur me përcaktimin e specialiteteve. Në kendveshtrimin tonë, por edhe në atë ligjor, ky fakultet nuk kishte pse të ishte në janar 2020, pas gati një viti, sërisht pjesë e procesit të konsultimeve, pasi kjo fazë ishte e superuar dhe po krijonte pengesa të panevojshme.

Edhe pse për institucionin tonë e gjithë kjo situatë e krijuar nga Ministria e Arsimit dhe FSHS ishte e tepërt dhe pengonte e penalizonte rreth 200 psikologë në pritje të realizimit sa më parë të provimit të shtetit, për të vijuar bashkëpunimin dhe finalizimin e këtij procesi, që kishte marrë më shumë se 2 vite për t'u realizuar, si dhe në përgjigje të propozimeve të bëra nga FSHS i UT,

propozoi përfundimisht ndarjen e specialiteteve si më poshtë:

1) Psikologji - Profili "**Psikologji Klinike dhe të tjera në fushën e Shëndetit Mendor**"

2) Psikologji - Profili "**Psikologji Shkollore dhe të tjera në fushën e Edukimit**"

3) Psikologji – Profili "**Psikologji e Komunitetit dhe të tjera në fushën Sociale**"

4) Psikologji – Profili "**Psikologji Pune dhe Organizacionale**"

5) Psikologji - Profili "**Psikologji Ligjore dhe të tjera në fushën Juridike**".

Në bazë të këtyre nënspecialiteteve u dakordësua të vijohej me projekt vendimin përfundimtar të VKM që do t'i propozohej ministrive të linjës për miratim.

Urdhri i Psikologut është tashmë në pritje të hartimit të projekt - VKM nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe përcjelljen e tij për miratim në Këshillin e Ministrave.

Ndërkohë Urdhri i Psikologut ka bërë gati grupet e pedagogëve, të cilët, në bazë të legjislacionit në fuqi, do të bëjnë hartimin e pyetjeve të specialiteteve të propozuara.

6. BUXHETI

6.1 TË ARDHURAT

Projekt-Buxheti i vitit 2019 parashikonte mbledhjen e të ardhurave në masën 7,270,000 lekë, nisur nga pritshmëria se do të kishte 110 regjistrime të reja, ndaj do të realizohej mbledhja e 850 kuotizacioneve vjetore. Ndërkohë që ishte i pritshëm licencimi i 70 psikologëve të rinj dhe tarifa e licencimit të tyre do të sillte rreth 1,050,000 lekë në buxhet. Rezulton se përafërsisht, ne vitin fiskal 2019, është realizuar përmbushja e të ardhurave si me poshtë:
Kuotizacione: 914 anëtarë, në total 5,484,000 lekë.
Licencime: 86 anëtarë, në total 1,290,000 lekë.
Regjistrime: 323 anëtarë, në total 646,000 lekë.
Gjithashtu, për herë të parë u siguruan të ardhura nga procesi i edukimit në vazhdim, në masën 120,000 lekë.

Nga sa më sipër është realizuar një total të ardhurash prej rreth 8,270,000 lekë, pra më shumë se ç'ishte parashikuar dhe për këtë ka ndikuar tejkalimi i mbledhjes së të ardhurave në zërin e licencimeve dhe mbledhjes së tarifës së regjistrimit (ri-regjistrimit).



6.2 SHPENZIMET

Nisur nga eksperienca e grumbulluar në këto tre vite të para, për efekt të menaxhimit sa më të mirë të të ardhurave dhe shmangien e situatave kritike ekonomike, është ruajtur një balancë e arsyeshme për shpenzimet e detyrueshme, për t'u realizuar sipas planifikimit.

Sipas projekt-buxhetit të vitit 2019, ishte parashikuar realizimi i shpenzimeve të miratuara sipas zërave si më poshtë:

Paga – 3,308,000 lekë
Shpenzime operative – 3,932,000 lekë
Shpenzime kapitale – 30,000 lekë

Rezulton se zëri paga është shpenzuar sipas parashikimeve dhe nuk ka patur ndryshime gjatë këtij viti.

Në zërin e shpenzimeve operative janë shpenzuar 4,441,000 lekë, pra rreth 500,000 lekë më shume se ç'kanë qënë të parashikuara në projekt-buxhet.

Kjo ka ardhur së pari për shkakun se të ardhurat jane mbledhur mbi masën e parashikuar, çfarë ka mundësuar kryerjen e shpenzimeve të nevojshme të paparashikuara, si p.sh. shpenzimet për software dhe programim IT.

Ky shpenzim ka qënë i paplanifikuar, por u kthye në emergjencë për shkak të sulmit kibernetik kundër faqes zyrtare të internetit të Urdhrit, që krijoji nevojën e rikrijimit të saj dhe marrjen e masave mbrojtëse të sigurisë për të ardhmen. Kjo ngjarje solli si pasojë edhe dëmtimin serioz të regjistrit elektronik, i cili tashmë u konceptua në formën e një platforme të mbrojtur.

Tabela Përmbledhëse e Buxhetit për vitin 2019

Emërtimi		**Vlera**	**Monedha**
		në 000/ lekë	
Të ardhurat:			
Kuotizacionet e anëtarëve		5,484	ALL
Tarifa për regjistrim		646	ALL
Tarifa për licensim		1,290	ALL
Të ardhura nga edukimi ne vazhdim		120	ALL
Të ardhura të tjera të ligjshme		50	ALL
Rezerva nga viti i kaluar		680	ALL
Totali		**8,270**	**ALL**
Shpenzimet:			
Paga		**3,317**	ALL
Shpenzime Operative		**4,441**	ALL
Shpenzime Kapitale		**-**	ALL
Total		**7,758**	**ALL**
Rezerva për vitin pasardhës		**412**	**ALL**

Një tjetër zë shpenzimesh i tejkaluar nga parashikimi në projekt-buxhet ka qënë zëri i ekspertëve të jashtëm, e nevojshme kjo për shkak të përballjes me proceset e njohura gjyqësore, të iniciuara që në vitin e parë të punës të Urdhrit, si dhe nevojën e që Këshilli Kombëtar të asistohej gjatë hartimit dhe miratimit të Rregullores së Edukimit në Vazhdim, nga ekspertë të kualifikuar.

Zëri i shpenzimeve për aktivitete sociale për anëtarët e Urdhrit, megjithëse i ulët në parashikim për shkak të kujdesit buxhetor, ka patur në realizimin faktik gati trefishim të tij nga parashikimi, për shkak të rritjes së aktiviteteve në terren në dobi të drejtpërdrejt të anëtarëve, që sigurisht është bërë e mundur vetëm nga tejkalimi i mbledhjes së të ardhurave.

Gjithashtu, një rritje të lehtë kanë patur edhe zërat e shpenzimeve për marrëdhëniet ndërkombëtare, (nisur nga dy eventet e rëndësishme, siç ishte anëtarësimi në EFPA dhe EAWOP),

shpenzimet për botime, etj., fakt që tregon zgjerimin e aktivitetit në fushën operacionale të Urdhrit të Psikologut.

Gjatë vitit 2019 nuk janë bërë shpenzime kapitale, pavarësisht parashikimit të tyre, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar.

Siç shihet, buxheti faktik i vitit 2019 ka ruajtur një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institucionit, si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë të re të funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përmbushë misionin ligjor për të cilin është krijuar në bazë të ligjit 40/2016 për "Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë".

7. OBJEKTIVAT E REALIZUAR GJATË VITIT 2019

- Rritja e numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Zgjerimi i rrjetit të koordinatorëve lokalë
- Ruajtja e bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin qëndror dhe lokal, jo vetëm në fuqizimin e rolit të psikologut, por edhe në projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat kanë faktorizuar punën e psikologut në terren.
- Formalizimi i marrdhënieve me OJF-të më të rëndësishme në vend, me qëllim rritjen e punësimit të psikologëve në projekte të ndryshme.
- Implementimi i projekteve të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare për fuqizimin dhe përmirësimin e rolit të psikologut në vend dhe më gjerë.
- Marrja e statusit të vendit anëtar me të drejta të plota në Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP).
- Marrja e statusit të vendit anëtar me të drejta të plota në Federatën Europiane të Shoqatave të Psikologëve, (European Federation of Psychologists' Associations "EFPA").
- Fillimi aktivitetit të Komisionit të Edukimit në Vazhdim, duke u plotësuar të gjithë aktet e duhura normative.
- Organizimi i aktiviteteve të para të edukimit në vazhdim, që mundëson marrjen e krediteve nga psikologët, të nevojshme në procesin e rilicencimit.
- Ndjekja e të gjithë procedurave dhe nxitja e organeve më të larta shtetërore për realizimin sa më parë të provimit të shtetit.

8. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2020

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- Vijimi i ndjekjes së procedurave për realizimin e provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut.
- Fuqizimi i rolit dhe statusit të psikologut në institucione, nëpërmjet miratimit të protokolleve të punës për secilën fushë të kompetencës.
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në rastet e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionit e përhershme dhe grupet e punës të kësaj organizate.
- Përmirësimi i rregullores së Edukimit në Vazhdim, me synim ofrimin e aktiviteteve sa më cilësore dhe të përballueshme për psikologët, duke e bërë sistemin e edukimit në vazhdim sa më funksional
- Riformatimi i Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor për të garantuar njëtrajtshmëri, profesionalitet dhe efikasitet në vendimmarrje.
- Sensibilizimi mbi rolin e psikologut organizacional dhe ndërrmarrja e nismave për aplikimin në vend të psikologjisë organizacionale në institucione publike dhe private.
- Rritja e bashkëpunimit dhe formalizimi i marrëveshjeve dypalëshe me Shoqatën Amerikane të Psikologjisë (American Psychological Assocation – APA), në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës dhe ndihmës reciproke, për fuqizimin e rolit të psikologut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Marrja e statusit të vendit anëtar me të drejta të plota në Unionin Ndërkombëtar të Shkencës së Psikologjisë (International Union of Psychological Science - IUPsyS), si një nga organizatat më të rëndësishme botërore në fushën e psikologjisë.